



Prishtinë, 23 qershor 2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1251\_2020

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Neni 25, Neni 26, Neni 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.10 dhe 2.11, Nenin 30 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 3 par. 1 nënpar. 1.11, Nenin 4, Nenin 7, Nenin 8 dhe Nenin 15 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 23 dhe Nenin 75 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, dhe
- Aplikacionin e datës 03.03.2020 për licencim të furnizimit me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike, të bërë nga ndërmarrja "**Balkan Energy**" LLC, adresa: Isa Boletini, 54/2, Gjilan, Republika e Kosovës.

**në seancën e mbajtur me datë 23 qershor 2020, nxori këtë:**

## V E N D I M

- I. I LËSHOHET Licenca** për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike ndërmarrjes "**Balkan Energy**" LLC, me numër licence ZRRE/Li\_ZRRE/Li\_67/20 për periudhën nga data 23 qershor 2020 deri 22 qershor 2025.

## A r s y e t i m


- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 03.03.2020 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për licencim të furnizimit me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike nga ndërmarrja "Balkan Energy" LLC.
- o ZRRE ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka aplikuar sipas legjislacionit në fuqi për Licencim, udhëzimeve të ZRRE-së lidhur me aplikimin si dhe kërkesave/dëshmive të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim.



- Pas vlerësimit fillestar të aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar se disa nga dëshmitë e aplikacionit duhet plotësuar andaj edhe ka kërkuar nga aplikuesi të dërgoi në ZRRE dokumente shtesë.
  - Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të dëshmimeve të kërkuara sipas aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë me kapacitet deri **200 MW**, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Arsim Janoya, u.d. kryesues

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Të licencuarit "Balkan Energy" LLC,
- Arkivit të ZRRE-së.